

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6816
E premte, 3 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Osmani kërkon ndihmën e
Islandës për anëtarësimin
e Kosovës në Këshillin e
Evropës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSHTET E KURTIT PËR ASOCIACIONIN

FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në seancën e së enjtes në Kuvend ka treguar gjashtë kushtet për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kushti i parë, sipas tij, është që të

jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet që janë në fuqi. Kurti ka theksuar se Asociacioni nuk mund të jetë monoetnik. Sipas tij, duhet ta ndërrojë emrin dhe nuk mund të

ketë/bartë asnjë pushtet publik. Ndërkaq përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se data 2 shkurt do të mbahet mend si datë e pranimit të Asociacionit nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti

APELI UA UL DËNIMIN GUCATIT DHE HARADINAJT PËR TRE MUAJ

FAQE 3



U.D. KRYETARI I
OVLUÇK-së: SPECIALJA,
GJYKATË POLITIKE | FAQE 3

AKTUALE



URSULA VON DER LEYEN NGA
KIEVI: BE-JA QËNDRON PRANË
UKRAINËS | F. 2

SEANCË E TENSIONUAR NË
KUVENDIN E SHQIPËRISË PËR
"RASTIN MCGONIGAL" | F. 3

BQK-JA I DËRAGON NË QEVERI DHE
KUVEND EMRAT PËR GUVERNATOR

F. 8

EKONOMI



FILLON PILOTIMI PËR LAJMËRIMIN
NË SHTËPI PËR PENSIONISTË | F. 7

MEHMETI: ASISTENÇA TEKNIKE E
FMN-SË PËR BQK-NË KISHTE NDIKIM
TË MADH NË SEKTORIN FINANCIAR

F. 8

SPORT



TË SHTUNËN BOKSOJNË
DY SHQIPTARËT ALTIN ZOGAJ
DHE FESTIM KRYEZIU | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Austria dëbon katër diplomatë rusë

VJEN, 2 SHKURT - Ministria e Jashtme e Austrisë ka njoftuar të enjten se ka dëbuar katër diplomatë rusë për veprime që bien ndesh me statusin e tyre diplomatik.

Ministria e jashtme austriake

ka theksuar se diplomatët duhet të largohen nga vendi deri më 8 shkurt. Kjo ministri ka bërë me dije se dy diplomatë punonin në ambasadën ruse, ndërsa dy të tjerët ishin anëtarë të misionit rus në Kombet e

Bashkuara në Vjenë, por nuk u dhanë më shumë detaje. Deri tani nuk ka pasur reagim nga Moska. Në prill të vitit 2022 Austria kishte dëbuar katër diplomatë të tjerë rusë me arsyetimin e njëjtë. Deri tani shumë shtete të BE-

së kanë dëbuar diplomatë rusë pas dënimit ndërkombëtar të mizorive që pretendohet se forcat ruse kanë kryer ndaj civilëve ukrainas. Pushtimi rus i Ukrainës ka hyrë në muajin e 12.



Brenda dy vjetësh Bullgaria organizon zgjedhjet e pesta

SOFJE, 2 SHKURT - Presidenti bullgar Rumen Radev ka nënshkruar një dekret për shpërndarjen e parlamentit dhe caktimin e 2 prillit datë për zgjedhjet e parakohshme - të pestat në vend në dy vjet pasi tri tentativa për formimin e Qeverisë së Bullgarisë dështuan. Të enjten Radev riemëroi Galab Donev kryeministër të përkohshëm.

Përbërja e qeverisë së përkohshme ka mbetur pothuajse e pandryshuar, me përjashtim të ministrit në largim të Kulturës, Velislav Minekov, i cili është zëvendësuar nga dirigjenti Najden Todorov. Radev tha se zgjedhjet e

parakohshme ishin të domosdoshme pasi Partia Socialiste e Bullgarisë (BSP) deklaroi më 24 janar se nuk kishte arritur ta formonte qeverinë dhe e kishte kthyer mandatin te presidenti.

Paraprakisht, dy grupet më të forta në parlamentin bullgar - partia e qendrës së djathtë, Qytetarët për Zhvillimin Evropian të Bullgarisë (GERB) dhe partia reformiste Ne Vazhdojmë Ndryshimin (PP), të cilat morën vendin e parë, respektivisht të dytë në zgjedhjet e tetorit të vitit të kaluar, kishin dështuar në dy tentativa të gjenin mbështetje për ta formuar Qeverinë e



Bullgarisë, por dështuan. Presidenti më pas ia dha BSP-së të drejtën për ta përmbushur mandatin, por edhe kjo parti dështoi. Kështu,

vendi do të shkojë përsëri në zgjedhje.

Bullgaria, me një popullsi prej afër 7 milionë banorësh, është në krizë politike që nga viti

2020, kur vendi u përball me protesta mbarëkombëtare pas zemërimit të publikut të akumuluar për shumë vjet për shkak të korrupsionit.

Pjesa më e madhe e zemërimit ishte lidhur me liderin shumëvjeçar Boyko Borisov dhe partisë së tij, GERB.

Qeveria e fundit, e udhëhequr nga Kiril Petkov, kolapsoi në qershor vetëm gjashtë muaj pasi mori mandatin, pasi njëri prej partnerëve doli nga koalicioni qeverisës.

Petkov, që udhëheq partinë Ne Vazhdojmë Ndryshimin, është përballur me sfida për përmbushjen e zotimeve të tij për ta çrrënjësuar korrupsionin.

Ministri ukrainas thotë se Rusia po planifikon ofensivë më 24 shkurt



KIEV, 2 SHKURT - Ministri ukrainas i Mbrojtjes, Oleksii Reznikov, tha se Rusia po përgatit një ofensivë të madhe dhe paralajmëroi se ajo mund të fillojë më 24 shkurt. Ai tha se Moska kishte grumbulluar mijëra trupa dhe se mund të "provojë diçka" për ta shënuar përvjetorin e pushtimit, që nisi në shkurt të vitit të kaluar. Javën e kaluar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania kanë bërë me dije se do të dërgojnë tanket Abrams, respektivisht Leopard, në Ukrainë.

Ukraina ka thënë se këto tanke

do t'i ndihmojnë që të përballet me ndonjë ofensivë potenciale të Rusisë në pranverë.

Zelensky ka thënë se shtetit të tij do t'i duhen të paktën 300 tanke Leopard për ta mposhtur Rusinë.

Shumë shtete evropiane kanë tanke Leopard 2 në inventarët e tyre dhe vendimi gjerman nënkupton se disa shtete mund të bëjnë dërgesa në Ukrainë. Gjermania shpreson se rreth 90 tanke të tilla do të dërgohen në fushëbetë.

Polonia dëshiron të eksportojë 14 tanke Leopard 2, ndërsa

Norvegjia ende nuk e ka bërë të ditur numrin e saktë.

Mbretëria e Bashkuar ka qenë vendi i parë anëtar i NATO-s që është zotuar për dërgim të tankeve moderne në Ukrainë.

Kryeministri britanik Rishi Sunak ka thënë se do të dërgojë në Ukrainë 14 tanke Challenger 2, modelin më modern të tankeve në ushtrinë britanike.

Rusia që ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022 ka më shumë tanke sesa Ukraina, por modelet që Moska ka janë shumë inferiore krahasuar me tanket përëndimore.

Ursula von der Leyen nga Kievi: BE-ja qëndron pranë Ukrainës

KIEV, 2 SHKURT - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe një delegacion prej 15 komisionerash, janë në Kiev për një Samit të përbashkët me Qeverinë e Ukrainës. "Ndihej mirë që u ktheva në Kiev, hera ime e katërt që nga pushtimi i Rusisë", ka shkruar në rrjetet sociale von der Leyen pas mbërritjes në kryeqytetin ukrainas me tren. "Kësaj radhe, me ekipin tim të komisionarëve. Ne jemi këtu së bashku për të rregulluar se BE-ja qëndron pranë

Ukrainës si kurrë më parë. Dhe për ta thelluar më tej mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë", ka shkruar ajo. Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell dhe komisionari i zgjerimit, Oliver Varhelyi, janë midis anëtarëve të delegacionit.

Von der Leyen u takua me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskiy më 2 shkurt, ndërsa presidenti i Këshillit Evropian Charles Michel do të arrijë në Samitin më 3 shkurt.



Apeli ua ul dënimin Gucatit dhe Haradinajt për tre muaj

HAGË, 2 SHKURT - Gjykata e Apelit në Dhomat e Specializuara në Hagë vendosi të enjten që t'i ulë dënimet për tre muaj për ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Dënimet e njësuara, sipas Apelit, do të jenë prej 4 vjetësh e tre muaj burgim dhe paneli i Apelit tha se koha e qëndruar në paraburgim do t'u llogaritet në dënim.

Më 18 maj 2022 Gucati dhe Haradinaj u shpallën fajtorë për pengim të administrimit të drejtësisë, duke u dënuar me nga katër vjet e gjysmë burgim.

Që të dy janë në paraburgim në Hagë që nga shtatori i vitit 2020.

Paneli i Apelit, gjatë seancës të mbajtur më 2 shkurt, tha se Gucati kishte paraqitur 20 arsye dhe disa pika, ndërkaq Haradinaj 24 arsye të tjera.

Nga to, Paneli pranoi vetëm një prej tyre, për pikën gjashtë të aktakuzës për zbulimin e paautorizuar të identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur.

Paneli pranoi një prej pikave të apelit të të akuzuarve që kishin të bënin me një person që publikisht kishte pranuar se po bashkëpunon me prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar. "Paneli i Apelit gjykon se konstatimet me frikën dhe shqetësimin e këtij personi, shkaktuar nga përmendja e emrit të tij publikisht si dëshmitar, nuk bazohen në këtë çështje gjyqësore", ka njoftuar paneli i Apelit.

Po ashtu, Apeli vlerësoi se gjykata



kishte gabuar kur kishte bashkuar disa vepra penale në një të vetme, por vlerësoi se një gjë e tillë nuk ndikoi në dënimin e shqiptuar në shkallën e parë.

Ndryshe avokatët e Gucatit dhe Haradinajt menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit në shkallën e parë kishin apeluar vendimin, duke thënë se presin zvogëlim të dënimin. Ata kishin argumentuar se një dënim i tillë "është dukshëm i tepërt dhe përtej ndonjë dënimi të shqiptuar më përpara në ndonjë tjetër rast të krahasueshëm".

Haradinaj dhe Gucati u arrestuan më 5 shtator të vitit 2020 dhe që nga ajo kohë janë në qendrën e paraburgimit në Hagë. Ata dyshohej se po atë vit, përmes disa konferencave për medie, në selinë e OVL-UÇK në Prishtinë kishin shpërndarë për gazetarët dokumente të klasifikuara të Dhomave të Specializuara.

Sipas Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Gucati dhe Haradinaj

kishin zbuluar informacion të mbrojtur, duke synuar të zbulonin qindra dëshmitarë apo dëshmitarë të mundshëm të Dhomave të Specializuara, që njihen edhe si Gjykata Speciale. Prokuroria e Specializuar ka argumentuar se me shqiptimin e dënimin ndaj Gucatit dhe Haradinajt është "vendosur drejtësi". "Frikësimi apo hakmarrja ndaj këtyre viktimave është, sipas mendimit tim, krim shumë i rëndë që godet në zemër aftësinë e këtij institucioni për të dhënë drejtësi dhe sundimin e ligjit", kishte deklaruar prokurori i atëhershëm i Specializuar, Jack Smith.

Në aktakuzë thuhet se dokumentet që u shpërndan nga Gucati dhe Haradinaj kanë pasur emra të dëshmitarëve potencialë të cilët do të mund të dëshmonin kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë edhe në rastin kundër ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-krerëve të Kuvendit, Kadri Veseli

dhe Jakup Krasniqi, dhe ish-deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Këta të fundit akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe pritet që gjykimi ndaj tyre të nisë në mars.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare

të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës të vitit 2011, autor i të cilit është senatori i atëhershëm zviceran Dick Marty. Gjykata ka selinë në Hagë, por funksionon sipas ligjeve të Kosovës.



U.d. kryetari i OVLUÇK-së: Specialja, gjykatë politike

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, pas këtij vendimi ka theksuar se Gjykata Speciale është gjykatë politike. "Ashtu siç e kemi thënë vazhdimisht që nga themelimi i saj, ashtu e konsiderojmë, se Gjykata Speciale është gjykatë politike. Në vend se të hetohen skandalet e prokurorisë së dhomave të specializuara që u dolën nga zyrat e tyre në Hagë, gjykata vazhdon me vendim politik ndaj krerëve të OVL UÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinaj", ka shkruar Klinaku në "Facebook".

Seancë e tensionuar në Kuvendin e Shqipërisë për "rastin McGonigal"

TRANË, 2 SHKURT - Kryeministri Edi Rama nuk mori pjesë në seancën parlamentare ku ishte parashikuar të zhvillohej interpelanca e thirrur nga Partia Demokratike (PD) për lidhjet e ish-agjentit të lartë të FBI-së, Charles McGonigal, me Shqipërinë. Kjo seancë u zhvillua me tensione në mes të Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste.

Grupi parlamentar i PD-së i dërgoi Kuvendit kërkesën për interpelancë urgjente ditën e shtunë (28 janar). Partia opozitare i kërkoi sqarime kryeministrit Edi Rama për çështjet se "çfarë është diskutuar me ish-zyrtarin e FBI-së dhe në çfarë cilësie e ka takuar atë; sqarime edhe në lidhje me biznesmenin rus Oleg Deripaska; dhe përse qeveria shqiptare i ka dhënë koncesione dhe statusin e investitorit strategjik".

Listës së gjatë të pyetjeve të opozitës u përgatit t'i përgjigjej ministrja për marrëdhëniet me

Parlamentin, Elisa Spiropali, por një gjë e tillë nuk u pranua nga opozita. Për shkak se deputetët e opozitës bllokuan foltoren e Kuvendit, seanca u ndërpre dy herë, por as pas pushimit, situata nuk ndryshoi.

Deputetët demokratë përplasën tavolinat me duar si dhe bllokuan foltoren, ndërsa nuk munguan as fishkëllimat e bilbilave.

Kreu i grupit parlamentar i PD-së, Enkeljd Alibeaj, tha se "fshehja dhe heshtja e kryeministrit Edi Rama" tregon, sipas tij, "se ai është i inkriminuar".

"Kryeministri ka detyrim politik, institucional dhe gjyqësor t'i përgjigjet kërkesës për interpelancë personalisht dhe jo ta delegojë. Ai do të heshtë. Heshtja e tij tregon inkriminim e tij. Ajo çka do të jetë sjellja e opozitës është t'i ushtrojmë detyrat tona në bazë të institucioneve politike. Të durojmë që ai të dalë dhe të flasë. Nëse ai nuk vjen, faktikisht



ka ndodhur diçka. Sot ky vend nuk ka kryeministër. Ka dy seanca që nuk vjen dhe që nuk përgjigjet për një çështje", tha Alibeaj.

Kryeministri Edi Rama iu përgjigj opozitës përmes rrjetit social "Twitter". "Abuzim total me lirinë e fjalës, me të vërtetën, me publikun, në një dëshpërim total moral, politik, elektoral, ku me shpifje ekstreme synohet

manipulimi i opinionit me një çështje të hetuar nga drejtësia amerikane që ka shkruar në gjykatë e që s'ka asnjë lloj lidhje me ne këtu", shkroi Rama.

Sipas kryeministrit, kjo çështje po përdoret nga opozita. Ish-agjenti i lartë i FBI-së, Charles McGonigal, u arrestua më 21 janar. Ai akuzohet për shkelje të sanksioneve të ShBA-së dhe pjesëmarrje në pastrim të

parave, derisa ka punuar me biznesmenin rus Oleg Deripaska të cilin e ka ndihmuar të hetojë një oligark rival rus.

Arrestimi dhe akuzat ndaj tij sollën reagime të shumta në Shqipëri. Sipas aktakuzës, nga gushti i vitit 2017 McGonigal nuk ia ka zbuluar FBI-së marrëdhënien e tij me një ish-zyrtar të agjencisë së inteligjencës shqiptare - i përshkruar në aktakuzë si "Personi A", prej të cilit ka marrë 225 000 dollarë.

Gjithashtu, ai nuk ka bërë me dije se "ka pasur kontakte" me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Në lidhje me këtë çështje, kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, i ka thirrur qytetarët në protestë më 11 shkurt, ndërsa opozita ka dorëzuar një kallëzim ndaj kryeministrit Edi Rama në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (SPAK) dhe ka kërkuar të nisin hetimet. /REL/



Kushtet e Kurtit për Asociacionin

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në seancën e së enjtes në Kuvend ka treguar gjashtë kushtet për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kushti i parë, sipas tij, është që të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet që janë në fuqi. Kurti ka theksuar se Asociacioni nuk mund të jetë monoetnik. Sipas tij, duhet ta ndërrojë emrin dhe nuk mund të ketë/bartë asnjë pushtet publik. Ndërkaq përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se data 2 shkurt do të mbahet mend si datë e pranimit të Asociacionit nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe mund të konsiderohet me disa kushte, mes të tjerash, ai "duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës".

Një tjetër kusht, sipas tij, është që Asociacioni nuk mund të jetë njëetnik. Ai "duhet ta ndërrojë emrin, nuk mund të bartë asnjë pushtet publik apo ekzekutiv dhe duhet t'i shërbejë vetëm bashkëpunimit horizontal të komunave, sipas Kushtetutës

dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale".

Kështu deklaroi ai gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës më 2 shkurt. "Normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër të marrëveshjes duhet t'i garantojë edhe të drejtat e komuniteteve pakicë dhe mekanizmat përkatës institucionalë. Shteti normal demokratik nuk i diskriminon pakicat, por i mbron ato si vlerë themelore e i ruan ato si pasuri shoqërore. Normalizimi i jashtëm i marrëdhënieve duhet t'i kontribuojë normalizimit të brendshëm të shteteve. Asociacioni i Komunavem i dalë

në parim nga marrëveshja e Brukselit Thaçi - Daçiq e 19 prillit 2013, si një mekanizëm i tillë, mund të konsiderohet nga Republika e Kosovës me këto kushte: 1. Asociacioni duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. 2. Asociacioni nuk mund të jetë monoetnik, duhet të ndërrojë emrin, nuk mund të ketë/bartë asnjë pushtet publik (apo ekzekutiv) dhe duhet t'i shërbejë vetëm bashkëpunimit horizontal të komunave sipas Kushtetutës dhe ligjit për vetëqeverisje lokale (kreu 5). 3. Të drejtat e pakicave kombëtare dhe mekanizmat mbrojtës përkatës duhet ta ngërthejnë parimin e reciprocitetit ndërmjet dy shteteve respektive si dhe të marrin parasysh standardet dhe modelet evropiane. 4. Para vendosjes së Asociacionit, strukturat ilegale të Serbisë në veri shuhen dhe bëhet dorëzimi i të gjitha armëve ilegale. 5. Asociacioni është pjesë e marrëveshjes finale dhe zbatohet pas njohjes reciproke. Dhe vetëm pasi Serbia t'i ketë pranuar parimet e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara në

raportet e saj ndërshtetërore me Republikën e Kosovës. 6. Presidenti i Serbisë i tërheq letrat e dërguara te pesë shtetet anëtare të BE-së, dhe tek të tjerat, për mospranimin e aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në Bashkimit Evropian që paraqet edhe shkelje të po asaj marrëveshjeje Thaçi-Daçiq të 19 prillit 2013", ka thënë Kurti para deputetëve.

Ai ka thënë se në të gjitha takimet e deritanishme të organizuara me ndërmjetësin e Bashkimit Evropian dhe këshilltarët e lartë të vendeve partnere e mike të Quintit ka potencuar që sa më shpejt që është e mundur të arrihet pajtim final rreth propozimit franko-gjerman. "Këtë propozim ne e shohim si bazë të mirë për diskutime të mëtutjeshme dhe jemi të interesuar të punojmë sa më intensivisht që i njëjti të finalizohet dhe nënshkruhet nga palët. Andaj, kërkojmë nga zyra e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, z. Josep Borrell, që sa më parë të ftojë në takime të rregullta e të shpeshta në mënyrë që të avancojmë drejt finalizimit. Unë si gjithnjë deri

më tani jam i gatshëm që me konstruktivitetin maksimal të kontribuoj në gjetjen e zgjidhjes më të mirë të mundshme dhe po ashtu të sigurohem për mekanizma që garantojnë implementim të plotë të saj", ka theksuar Kurti.

Kryeministri Kurti ka thënë se pika 10, e fundit, e propozimit të BE-së për marrëveshje bazë, i dedikohet zbatimit të marrëveshjeve të deritanishme në procesin e dialogut të Brukselit dhe në kuadër të këtij neni do të trajtohen të gjitha marrëveshjet e mëhershme, përfshirë edhe ajo e 19 prillit 2013. "Çfarëdo tentative që nene të caktuara të marrëveshjes bazike të nxirren dhe të promovohen si nene ekskluzive apo parakushte për ecje përpara, janë sa të pakuptimta aq dhe joproduktive", është shprehur Kurti.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në fjalën e tij para deputetëve, ka thënë se data 2 shkurt është datë e pranimit të Asociacionit nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Abdixhiku ka thënë se Kurti e ka futur dialogun në qorrsohak dhe asnjëherë nuk ka raportuar në

Pse gjysmë milioni britanikë janë në grevë?



LONDËR, 2 SHKURT - Britania po përballet me valën më të madhe të veprimit sindikal në dekada, me punëtorët nga shumë sektorë, përfshirë atë të kujdesit shëndetësor dhe edukimit që kanë hyrë në grevë.

Pse po ndodhin grevat tani?

Thelbi i këtyre trazirave janë pagat.

Rritja mesatare e pagave në Britani u ngadalësua pas krizës financiare globale dhe u rrit gradualisht në gjysmën e dytë në dekadën e kaluar. Megjithatë, në përgjithësi rritja e pagave ishte më e vogël për punonjësit e sektorit publik dhe solli pak ose aspak rritje reale.

Dallimi në paga mes sektorit publik dhe privat është thelluar më shumë gjatë vitit të kaluar, teksa inflacioni në çmimet e konsumit arriti në shifra dyshifrore.

Pagat në sektorin privat në tre muaj, deri në nëntor të vitit të kaluar, u rritën 7.1 për qind krahasuar me një vit më parë, ndërsa paga mesatare e sektorit publik, në periudhën e njëjtë, u

rritë 3.3 për qind.

Shumë nga mospajtimet janë gjerësisht ose plotësisht në sektorët publikë, sikurse transporti dhe kujdesi shëndetësor, përfshirë edhe punonjësit e hekurudhave, personelin e emergjencave dhe infermierët.

Niveli më i lartë i inflacionit në Britani në 40 vjet është regjistruar muajt e fundit. Inflacioni prej rreth 10-përqindësh ka goditur shumicën e pagave në sektorin publik dhe ka shkaktuar një krizë të kostos së jetesës, që ka bërë që disa persona të drejtohen në organizatat që ofrojnë ndihma ushqimore.

Shumë sindikata kanë thënë se pagat e punëtorëve në dhjetë vjetët e fundit kanë shënuar një rritje modeste dhe ndikimi i inflacionit aktual ka ndërlikuar edhe më shumë situatën, pasi janë rritur çmimet e energjisë dhe qytetarët po ndiejnë efektet e pandemisë.

Cilat janë grevat më të mëdha?

Vetëm më 1 shkurt rreth gjysmë milion punëtorë u futën në

grevë, por veprimi sindikal ka prekur shumë sektorë.

Përderisa disa punëtorë të sektorit privat, nga stafi në porte e deri te shoferët e autobusëve, kanë arritur marrëveshje për pagat me punëdhënësit e tyre pasi kishin organizuar greva, pakënaqësia në shumë sektorë të tjerë publikë po vazhdon.

Stafi i transportit hekurudhor, infermierët dhe punëtorët e autoambulancave, mësuesit dhe shërbyesit civilë, po kërkojnë rritje të pagave që përputhen ose tejkalojnë inflacionin, si dhe disa kërkesa të tjera sa iu përket kushteve të punës.

Sindikata që përfaqëson mësuesit në sistemin arsimor të financuar nga shteti ka kërkuar një shpërblim monetar për shkak të inflacionit, që do të financohej plotësisht nga qeveria. Sindikata u ka ofruar mësuesve më me përvojë një rritje page prej 5-përqindësh, që do të paguhet nga buxhetet ekzistuese të shkollave. Afër 100 000 shërbyes civilë që punojnë për departamentet qeveritare e deri te punëtorët e agjencive po ashtu kanë hyrë në grevë duke kërkuar rritje page prej 10-përqindësh.

Cila ka qenë përgjigja e qeverisë?

Qeveria britanike, që merr këshilla nga trupa të pavarur kur përcakton rritjen e pagave në sektorin publik, u ka bërë thirrje sindikatave t'i ndërpresin grevat dhe të zhvillojnë bisedime me ekzekutivin.

Qeveria ka argumentuar se rritja e pagave, që do të përputhej edhe me nivelin e inflacionit, do të shkaktonte rritje të mëtejme të çmimeve dhe do të bënte që të rriteshin edhe më shumë normat e interesit dhe pagesat e kredive.

Kërkesat për rritje pagash vijnë gjithashtu pasi qeveria e kryeministri Rishi Sunak njoftoi për një paketë për rritjen e taksave dhe shkurtimeve e shpenzimeve, në përpjekje për t'i riparuar financat publike dhe për ta zbutur inflacionin.

Qeveria, po ashtu, ka paraqitur një plan për t'i garantuar nivelet minimale të shërbimit të sigurisë gjatë veprimeve sindikale nga zjarrfikësit, stafi i autoambulancave dhe punonjësit e hekurudhave. Sindikatat kanë thënë se ky ligj

është sulm ndaj lirisë për të mbajtur grevë.

Cili ka qenë ndikimi i grevave?

Grevat e rregullta kanë krijuar ndërprerje të transportit për udhëtarët dhe kanë dëmtuar rëndë industrinë e turizmit pasi njerëzit qëndruan në shtëpi. Një ministër, po ashtu, ka kërkuar nga britanikët t'i shmangin aktivitetet jashtë shtëpive në ditën kur punëtorët e autoambulancave janë në grevë.

Në periudhën midis qershorit dhe nëntorit kishte edhe më shumë greva sesa në një gjashtëmuajor në 30 vjet, tha Qendra për Kërkime të Ekonomisë dhe Biznesit (CEBR).

CEBR ka vlerësuar se grevat dhe ndikimi indirekt i mungesës së punëtorëve, që hyn në grevë, i kanë shkaktuar ekonomisë të paktën 1.7 miliard funte në tetë muaj gjatë vitit të kaluar, që është një pjesë e ekonomisë totale mbi 2 trilionë funtash. Po ashtu, është vlerësuar se grevat e mësuesve do t'i kushtojnë ekonomisë rreth 20 milionë funte në ditë, por kjo shifër nuk përfshin edhe problemet që u shkaktohen prindërve që nuk kanë mundësi të shkojnë në punë për shkak të grevës së punonjësve të arsimit.

Kur mund të ndalen grevat?

Shumica e grevave në sektorët e mëdhenj vazhdojnë edhe pse sindikatat, punëtorët dhe qeveria po vazhdojnë negociatat. Ka sinjale që stafi i hekurudhave dhe punonjësit janë duke shkuar drejt një zgjidhjeje. Ndërkaq, Sindikata e Infermierëve ka shprehur vullnet që të takohet me qeverinë lidhur me pagat, por duket se palët janë larg arritjes së një zgjidhjeje, teksa ministri i Shëndetësisë ka thënë se kërkesa për rritjen e pagave është e pamundur që të plotësohet.

(Reuters /Përgatiti: Mimoza Sadiku REL).

Kuvend për dialogun me Vuçiqin. "Kjo datë e sotme është datë e pranimit të Asociacionit nga kryeministri i Kosovës. Nuk po them që është mirë a keq. Unë po them që kryeministri i Kosovës tha që marrëveshja e vitit 2013, që është obligim ndërkombëtar, është e bëshme me disa kushte, por e bëshme është, dhe kushti kryesor është që ky Asociacion të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo ka qenë gjithmonë. Tani

kryeministri foli për një marrëveshje, për një pikë, numër 10, që s'e dimë se pse besoni ose jo tash e 6 muaj ky dialogun me Vuçiqin, por asnjëherë s'ka ardhur të dialogojë me deputetët në Kuvend", ka thënë Abdixhiku.

Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, tha se nuk e di se a është rastësi apo sinkronizim në mes të Kurtit dhe Vuçiqit, që në kohën kur në Kuvendin e Serbisë po diskutohet për

dialogun, kryeministri kosovar e jep lajmin për themelimin e Asociacionit. "Ky moment duhet të jetë një koordinim i mirë mes dy liderëve, Kurtit dhe Vuçiqit, të cilët në të njëjtën ditë, në të njëjtin moment, po japin lajme të rëndësishme për drejtimin që do të marrë kjo marrëveshje. Ajo që është e rëndësishme është ndryshimi radikal, drastik, që është ndryshim jashtëzakonisht i madh i diskursit të Kurtit", ka thënë Tahiri.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka theksuar se Albin Kurti është kryeministër i Asociacionit. "Direkt nga foltorja e Kuvendit, kryeministri e shpalli planin. Edhe për skeptikun e fundit, sot u bë e qartë që Asociacionin e bën Albin Kurti. Por paska vendosur kushte për formimin e Asociacionit. Dhe kushtet që na i paska! Kur ky thotë njohja si kusht, e ka fjalën për planin franko-gjerman. Kur ky thotë nuk ka Asociacion monoetnik,

po thërret që duhet t'i ndërrohet emri. Kjo është mënyra e tij e operimit. Nuk ka vend për befasi. Logjika doli zhveshur. Plani dhe asociacioni u pranuan. Kryeministër, cila është dita e nënshkrimit? Tregojë datën!", ka thënë Molliqaj.

Ai i ka ftuar të gjithë ata që janë kundër Asociacionit të bëhen bashkë për organizim të protestave. "Kundërshtimi dhe organizimi janë në horizont", ka deklaruar Molliqaj.

Latifi takon shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë: Rahoveci ka potencial për investime

RAHOVEC, 2 SHKURT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë në Prishtinë, Rastislav Kostilnik. Latifi e ka falënderuar për vizitën dhe e

ka njoftuar për veçantitë, të arriturat si dhe mundësitë që ka Rahoveci. "Po ashtu, e informova se komuna e Rahovecit radhitet shumë lart në performancë, transparencë dhe në shumë aspekte të qeverisjes. Para z.

Kostilnik paraqita edhe potencialin e madh që ka Rahoveci për investime në shumë fusha, posaçërisht investimet që pritet të bëhen në fushën e energjisë së ripërtërishme", ka theksuar Latifi pas takimit.



Bislimi takon shefen e Departamentit të Ekonomisë dhe Inovacionit në Vaud, Isabelle Moret

PRISHTINË, 2 SHKURT - Veprimtari dhe drejtori i OJQ "Zëri Perëndimor i Kosovës", Sali Bislimi, ka takuar këshilltaren e shtetit, shefen e Departamentit të Ekonomisë dhe Inovacionit në Vaud, Isabelle Moret, me të cilën ka diskutuar për çështjet që kanë të bëjnë në mes të Kosovës dhe Zvicrës.

Temë tjetër e diskutimit ishte edhe partneriteti migrimit në mes të Zvicrës dhe Kosovës, që do të luajë një rol të rëndësishëm ekonomik mes dy vendeve tona. "Sot kam kënaqësinë kur shoh që shqiptarët i gjen në ndërtimin e Zvicrës, ata janë gjithkund, në shtëpitë e pleqve, në spitale, në ndërtimin e rrugëve, që në realitet pasurojnë Zvicrën, që me afrimin e dy vendeve tona jemi fitues të gjithë", ka shkruar Sali Bislimi në "Facebook".

Moret ka vizituar Kosovën kur ishte kryetare e parlamentit zviceran. "Me fjalët e para më thotë që ju keni një vend shumë të bukur Kosovën. Unë tani kam dy vende, Kosovën dhe Zvicrën, që i dua dhe i



mbroj aq sa mundem, në çdo mundësi dhe rast që më jepet. Bëra edhe një përmbledhje

historike të Kosovës, luftën tonë për liri, dhe djemtë tanë që padrejtësisht gjenden në

Hagë. Kantoni Vaudit është i privilegjuar edhe nga zoti me bukuritë natyrore dhe me

humanizmin shpirtëror dhe njerëzor që ka", ka shkruar Bislimi.

Policia arreston një person për organizim të skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm



RAHOVEC, 2 SHKURT - Më 1 shkurt Sektori Rajonal për Hetime, në bashkëpunim me Stacionin Policor në Rahovec dhe Prokurorin e Shtetit, dhe në zbatim të urdhër-kontrollit të lëshuar nga gjykata, kanë kryer kontroll në tri lokacione mbi dyshimin për organizim të skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm. Në njërin nga këto lokacione (në fshatin Krushë e Madhe,

Rahovec) është arrestuar i dyshuari B. B., i lindur në vitin 1985, shtetas i Republikës së Kosovës, si dhe në cilësinë e provave materiale janë sekuestruar dy telefona mobilë dhe një shumë parash të cilat dyshohet se janë përdorur për kryerjen e veprës penale. Pas intervistimit dhe përfundimit të procedurave të tjera policore, me vendim të

Prokurorit të Shtetit, i dyshuari është ndaluar në mbajtje për 48 orë. Ndaj tij është iniciuar rast penal për hetim "Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm". Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të saj në interes të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike.

Komuna e Podujevës nënshkruan marrëveshje me KBI-në për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

PODUJEVË, 2 SHKURT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, Mensur Hoti, për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të

qytetarëve të Podujevës nga ana e komunës. Në bazë të marrëveshjes përfshihen shërbimet: transporti i kufomës, fletëlahmërimet (afishet), dërrasat, piramida, pastrimi i kufomës, mbulesa e kufomës dhe qefini. Marrëveshja është lidhur

për periudhën prej 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2024. Kryetari Bulliqi dhe kryetari i KBI-së, Hoti, u pajtuan që bashkëpunimin e mirë në mes të komunës dhe KBI-së ta vazhdojnë dhe ta thellojnë në interes të të gjithë qytetarëve pa dallim.



Osmani kërkon ndihmën e Islandës për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës në Rejkjavik, është pritur nga kryeministrja e Islandës, Katrin Jakobsdottir. Meqenëse Islanda aktualisht udhëheq presidencën e Këshillit të Evropës, diskutimet u fokusuan në shtyrjen përpara të anëtarësimin të Kosovës në këtë organizatë, duke pasur parasysh rëndësinë e saj për liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve të Kosovës.

Presidentja Osmani ka theksuar se Islanda, një nga shtetet e para njohëse të Republikës së Kosovës, është partnere e

rëndësishme dhe aleate e popullit të Kosovës. Në këtë drejtim, Osmani ka vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Islandës për anëtarësimin e Kosovës në strukturat ndërkombëtare, ndërsa ka shprehur gatishmërinë të shtohet komunikimi ndërshtetëror që të avancohet procesi i anëtarësimin në Këshillin e Evropës në muajt në vazhdim.

Në diskutim me kryeministren Jakobsdottir, presidentja Osmani ka përmendur vendosmërinë e popullit dhe institucioneve të Kosovës për anëtarësim në NATO dhe në këtë frymë ka kërkuar mbështetjen e Islandës si një nga shtetet themeluese të

Aleancës Veri-Atlantike.

Osmani ka përmendur përparimin e institucioneve të vendit për garantimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, duke përfshirë komizën kushtetuese dhe ligjore, e cila është shumë e avancuar dhe plotësisht e harmonizuar me të gjitha konventat ndërkombëtare.

“Modeli kushtetues në Kosovë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë është më i avancuari në Evropë”, ka shtuar presidentja Osmani, duke dhënë shembuj konkretë të këtij modeli.

Ajo ka thënë më tutje se anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës

do të ishte hap i rëndësishëm për fuqizimin dhe avancimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmave që i ofron Këshilli dhe do të ishte përparim për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim etnie apo religjioni. Presidentja, po ashtu, ka shtuar se ndërlidhja e procesit të anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës me procesin e dialogut nuk është i drejtë, ndërsa la theksuar se këto dy procese duhet të shihen si të ndara. “Andaj, anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës është reflektim i të arriturave të Kosovës në zbatimin e vlerave të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, të dëshmuar nga raportet e organizatave relevante

ndërkombëtare”, ka deklaruar Osmani.

Mbi temën e situatës së sigurisë në Evropë, presidentja Osmani ka ritheksuar përkushtimin e institucioneve të Republikës për paqe të qëndrueshme në rajon dhe më gjerë, ndërsa ka nënvizuar edhe rëndësinë e vazhdimin të mbështetjes së popullit ukrainas kundër agresionit rus.

Presidentja Osmani dhe kryeministrja Jakobsdottir kanë shprehur gatishmërinë që të thellohen marrëdhëniet e shkëlqyera në mes të Kosovës dhe Islandës në fusha të ndryshme dhe të hapen kapituj të ri të bashkëpunimit në mes të dy vendeve.



Fillon pilotimi për lajmërimin në shtëpi për pensionistë

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se ka filluar angazhimin e ekipeve mobile për qëllim të lajmërimin të pensionistëve në dhe mbi moshën 85-vjeçare nëpër shtëpitë/banesat e tyre në regjionin e Prishtinës (lajmërimet në shtëpi). Ky shërbim ka filluar të zbatohet fillimisht në regjionin e Prishtinës (komuna e Prishtinës, e Fushë-Kosovës, e Drenasit, e Lipjanit, e Podujevës, e Obiliqit dhe e Graçanicës) si pilotprojekt, për të vazhduar më pastaj edhe në regjionet dhe grupmoshat e tjera. “Paraqitja e kërkesës për këtë

shërbim bëhet në adresën elektronike pensionet.pr@rks-gov.net dhe është e kufizuar vetëm pensionistët që: a) Janë në apo mbi moshën 85 vjeçare (85+); b) Janë pensionistë të regjionit të Prishtinës; dhe c) Kërkesa është paraqitur së paku 7 (shtatë) ditë para datës kur pensionisti duhet të lajmërohet fizikisht pranë zyrave të Departamentit të Pensioneve. Kërkesa mund të paraqitet individualisht nga pensionisti apo nga çdo preson tjetër që e bën në emër të pensionistit. Kërkesat e tilla janë vlefshme vetëm nëse konfirmohet pranimi i shkresë elektronike, përndryshe



kërkesa duhet të përsëritet”, ka njoftuar Ministria e Financave. Në kërkesë pensionistët duhet të paraqesin edhe këto të

dhëna: a) emri dhe mbiemri i pensionistit; b) numri personal i pensionistit; c) numri i telefonit të pensionistit (nëse ka

- preferohet numër i mobilit); d) numri i telefonit të një personi të afërt të pensionistit; dhe e) adresa e banimit të pensionistit dhe përshkrimi shtesë lidhur me adresën. Pensionistit do t'i konfirmohet që kërkesa është pranuar, dhe pas verifikimit të të dhënave sipas kriterëve të të njoftohet për realizimin e vizitës përafërsisht 24 orë më herët, përfshirë këtu edhe ditët e vikendit.

Pensionistët të cilëve nuk u aprovohet kërkesa për shkak të mosplotësimin të kriterëve duhet të vazhdojnë të paraqiten për lajmërim në zyrat e pensioneve.

KGJK-ja i kërkon Avokatit të Popullit ta dërgojë në Kushtetuese Ligjin për Paga

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vlerësuar se Ligji për Paga në sektorin publik dhe vendimi i qeverisë për koeficientin paraqet një ndërhyrje të dëmshme në pavarësinë, integritetin dhe mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe se duhet të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese.

KGJK-ja ka kërkuar nga Avokati i Popullit të veprojë në kuadër të kompetencave ligjore duke kundërshtuar këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese. "Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në mbledhjen e mbajtur me datë 2 shkurt 2023, së bashku me Asamblenë e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, ka diskutuar dhe analizuar Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së

Kosovës për vlerën e koeficientit, si dhe efektin e këtyre akteve në sistemin gjyqësor. Këshilli Gjyqësor konsideron se Ligji për Paga në Sektorin Publik dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vlerën e koeficienteve, paraqet një ndërhyrje të dëmshme në pavarësinë, integritetin dhe mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor", ka reaguar KGJK-ja, duke theksuar se një ndërhyrje e tillë në sistemin gjyqësor është në kundërshtim të plotë me dispozitat kushtetuese, ligjore si dhe standardet evropiane që u garantojnë gjyqtarëve një sistem të pagave të parashikueshëm dhe nuk lejojnë uljen e pagave. "Për më tepër, një qasje e tillë ndaj gjyqësorit është në kundërshtim edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Ligjin për Gjykatat, Qëndrimet e Komisionit të Venecias dhe



Rekomandimet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe gjithë administrata gjyqësore, shprehin shqetësim që as Kuvendi dhe as Qeveria nuk kanë respektuar Vendimin e

Gjykatës Kushtetuese për sigurimin e pacenueshmërisë së pagave të sistemit gjyqësor, prandaj ftojme Avokatin e Popullit që të veprojë në kuadër të kompetencave ligjore duke kundërshtuar këtë Ligj në Gjykatën Kushtetuese. Këshilli

Gjyqësor i Kosovës, është i vendosur që të ndërmerr të gjitha veprimet kushtetuese dhe ligjore për të mbrojtur dhe promovuar pavarësinë institucionale dhe funksionale të sistemit gjyqësor", është thënë në reagimin e KGJK-së.

BQK-ja i dërgon në Qeveri dhe në Kuvend emrat për guvernator

PRISHTINË, 2 SHKURT - Banka Qendrore e Kosovës ka njoftuar se i ka dërguar në Qeveri dhe Kuvend emrat për përzgjedhjen e guvernatorit të ri. Sipas BQK-së, pas përfundimit të veprimeve procedurale, në listën e kandidatëve janë Ahmet Ismaili, Nexhat Kryeziu, Lulzim Ismajli e Shkëndije Himaj. "Pas përfundimit të veprimeve procedurale, më 01.02.2023 është dërguar në Kuvendin e Kosovës dhe Qeveri lista e kandidatëve për pozitën e guvernatorit/es të Bankës Qendrore të Kosovës", thuhet në njoftimin e BQK-së. Ismajli prin me 35.3 pikë nga 40 pikët maksimale, ndjekur nga Kryeziu me 34 pikë, ndërsa zëvendësguvernatori aktual Ismajli ka marrë 33 pikë dhe Himaj vlerësuar me 26 pikë. Sipas shpalljes që ishte bërë nga



BQK-ja, emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar më 29 mars 2023 ose në datën e emërimit, raporton "Telegrafi".

Në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës, guvernatori si kryeshef ekzekutiv i këtij institucioni është pjesë e Bordit dhe kryesues i Bordit Ekzekutiv.

Neni 38 i këtij Ligji përcakton edhe mënyrën e emërimit të shefit të saj.

Në pikën 1 të këtij neni thuhet se guvernatori dhe anëtarët joekzekutivë të Bordit të BQK-së emërohen për një mandat prej pesë vjetësh, ndërsa pika dy e këtij neni thotë se kurdo që paraqitet boshllëk do të konstituohet një panel

përzgjedhës që ka kompetenca për shqyrtimin e të gjithë kandidatëve i përbërë nga anëtarët e tjerë të Bordit të BQK-së dhe guvernatori, ku asnjëri prej tyre nuk kërkon riemërim.

"Paneli do t'i përzgjedhë të gjithë aplikantët në bazë të kualifikimeve dhe performancave gjatë intervistimit dhe do të japë shpjegim me shkrim për një përzgjedhje të tillë. Lista me radhitjen e të gjithë aplikantëve që konsiderohen nga paneli se kanë përmbushur kriteret do të dërgohet në Kuvend të Republikës së Kosovës dhe Qeveri, e cila mund t'i japë një mendim Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kusht që ky mendim të dërgohet në Kuvend të Republikës së Kosovës brenda

pesëmbëdhjetë ditëve", thuhet në pikën dy të nenit 38.

Mirëpo në fund kompetencat për përzgjedhjen e guvernatorit i takojnë Kuvendit të Kosovës. "Nga ajo listë, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të përzgjedhë një individ për secilën pozitë në bordin e Bankës Qendrore që duhet të plotësohet. Pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës të ketë bërë përzgjedhjen e fundit, do t'ia përcjellë presidentit këto propozime, i cili pastaj do të miratojë dhe do të emërojë një person për ta plotësuar pozitën", thuhet në nenin 38 të Ligjit për BQK-në.

Aktualisht BQK-ja udhëhiqet nga Mehmeti. Këtij të fundit i skadon mandati në mars të vitit të ardhshëm e që ishte emëruar më 2018.

Mehmeti: Asistenca teknike e FMN-së për BQK-në kishte ndikim të madh në sektorin financiar

PRISHTINË, 2 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore i Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se asistenca teknike e Fondit Monetar Ndërkombëtar, përmes Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar (Financial Sector Stability Review - FSSR), ka pasur ndikim të madh në sektorin financiar. "Mbështetja fillestare na ndihmoi t'i vendosim funksionet kryesore të institucionit tonë, duke

formësuar strukturën e sistemit tonë financiar si dhe stabilitetin e tij. Mbështetja e vazhdueshme po na ndihmon për forcimin e qeverisjes dhe kapaciteteve tona teknike, të cilat janë të nevojshme për t'i përballuar sfidat e reja dhe kompleksitetin në rritje të rreziqeve, dhe pasiguritë globale", ka deklaruar guvernatori Mehmeti. BQK-ja ka njoftuar se rishikimi i Stabilitetit të Sektorit

Financiar (FSSR) i FMN-së është një instrument për zhvillimin e kapaciteteve që ofron një bazë diagnostike, identifikon dobësitë kryesore në sistemet financiare dhe zhvillon një plan veprimi afatmesëm me prioritet për reformat e sektorit financiar të renditura mirë dhe, gjithashtu, plotësohet nga zhvillimi i kapaciteteve përcjellëse aty ku nevojiten më së shumti.



Të gjesh thelbin e vetvetes: Çfarë këshillon filozofi i lashtë kinez Zhuangzi

Nga Oscar DAVIS

Zhuangzi – i njohur gjithashtu si Zhuang Zhu apo Mjeshtëri Zhuang – ishte një filozof kinez që jetoi rreth shekullit IV Para Erës Sonë. Ai vlerësohet tradicionalisht si autori i kryeveprës së lashtë taoiste që mban emrin e tij, Zhuangzi. Vepra e Zhuangzi, është përshkruar si “me humor por edhe shumë serioze, e lehtë dhe e rëndë, e argumentuar saktësisht dhe enkaskonfuze”.

Në pamje të parë, mësimet e tij mund të duken tërësisht të pakuptimta. Ai thoshte se “dëgjimi ndalon me dëgjimin”, se ne duhet “ta fshehim botën tek bota”, dhe se një person në rrugën e duhur, është në fakt “duke ecur në dy rrugë”. Por Zhuangzi kënaqej ngaparadokset. Filozofia e tij luan qëllimisht me fjalën, për të zbuluar se vetë gjuha është pengesa kryesore në kërkimin për veten tonë thelbësore, dhe ndaj dëshirës tonë për të pasur një jetë të lumtur dhe të përmbushur.

Për Zhuangzi, fjalët mbajnë gjithçka që është e jashtme për veten tonë thelbësore: Kurthi i peshkut ekziston për shkak të vetë peshkut. Pasi të keni marrë prej andej peshkun, mund ta harroni kurthin. Laku i lepurit ekziston për shkak të lepurit. Pasi të keni marrë lepurin nga aty, mund ta harroni lakun.

Edhe fjalët ekzistojnë për shkak të kuptimit që kanë. Pasi të keni marrë kuptimin, edhe ato mund t'i harroni. Ku mund të gjej një njeri që ka harruar fjalët, që të mund të bisedoj me të?

Fjalët janë si enë për dallimet dhe vlerat konvencionale që trashëgojmë nga e kaluara.

Por gjuha, si bartëse e idealeve dhe pritshmërive shoqërore, shndërrohet në një burim të moszgjdhjes, të telasheve dhe ankthit, të cilat na e mohojnë kënaqësinë dhe qetësinë. Duke ndarë pikëpamjen e shprehur në librin “Tao Te Ching” të Laozit, Zhuangzi argumenton se ne duhet së pari të çorientohemi nga gjuha, për të zbuluar më pas se njohuritë më të larta gjenden përtej fjalëve.

Njëqind Shkollat e Mendimit

Zhuangzi ishte një kritik i ashpër i idealeve dominuese dhe kërkuese të kohës së tij. Ajo që njihet si Epoka e Artë e Filozofisë Kineze, zgjati nga shekulli V deri në shekullin III Para Erës Sonë në kohën e dinastisë Zhu. Lulëzimi i pikëpamjeve të ndryshme filozofike gjatë asaj kohe njihet si

Njëqind Shkollat e Mendimit. Shoqëria intelektuale ekzistonte për ta udhëhequr shoqërinë dhe sundimtarët e saj drejt Rrugës (e njohur edhe si Tao) – koncepti qendror dhe tipari praktik i Taoizmit. Dy shkollat mbizotëruese të Njëqind Shkollave të Mendimit ishin Konfucianizmi dhe Mohizmi. Në përgjithësi, konfucianizmi e centralizon përshtatshmërinë rituale dhe devotshmërinë familjare si vetëm disa nga virtytet e nevojshme të të qenit një “zotëri”, pra qytetarit ose sunduesit të drejtë dhe model.

Mohistët ishin kritikë ndaj konfucianëve. Ata mbrojtën një paanshmëri të llogaritur në shpërndarjen tonë të kujdesit. Një pikëpamje kjo, që në shumë mënyra të kujton atë që Perëndimi më vonë do ta quante “utilitarizëm”. Një kritikë e zakonshme e konfucianizmit, është se ai e vë shumë theksin tek rendi shoqëror përmes ritualeve dhe hierarkive.

Dikush mund të argumentojë, në lidhje me mohistët, se i vihet shumë theksi vendosjes së një parimi moral universal, në një mënyrë që rrezikon të anashkalojë tiparet komplekse të jetës sonë morale individuale. Zhuangzi e kundërshtoi spektrin e plotë të pikëpamjeve të tilla, duke supozuar në vend të kësaj se bindja nga konfucianët ose mohistët, varej kryesisht nga këndvështrimi individual.

Traditat dhe shkollat e mendimit, vendosin disa ideale transhendentale, të cilat rrezikojnë të largojmë shpirtat tanë nga ne në kërkimin e tyre për drejtësinë dhe të vërtetën. Për Zhuangzi, ajo që ka vërtet rëndësi është që ne të ruajmë një distancë të ndjeshme, skeptike nga dallimet konvencionale, dhe t'i rezistojmë angazhimit ndaj një botëkuptimi të veçantë.

E drejta nuk është e drejtë; kështu nuk është kështu. Nëse e drejta do të ishte vërtet e drejtë, do të ndryshonte aq qartë nga jo e drejta, sa që nuk do të kishte nevojë për argumentim. Nëse do të ishte vërtet kështu, do të ndryshonte kaq qartë nga jo kështu, sa që nuk do të kishte nevojë për argument.

Harrojini vitet; harrojini dallimet. Kaloni tek e pakufijshmja dhe bëjeni atë shtëpinë tuaj! Të adoptosh një skepticizëm të shëndoshë ndaj ideve të trashëguara, do të thotë “të zbrazësh enën e vetes”, ose ndoshta të ushtrosh një lloj “harrese” të stërvitur të asaj që është e jashtme për unin thelbësor.

Në këtë gjendje, ne bëhemi më pak të prirur për të marrë pjesë



në profesionet e tepërta, që i imponojmë vetes për të përballuar peshën e pritshmërive sociale. Kjo është ajo që do të thotë Zhuangzi, kur argumenton që ne duhet të stërvitim aftësinë tonë për të ekzistuar në këtë botë dhe jo jashtë saj.

Kështu që i urti endet në atë që ekziston kudo, dhe që nuk mund të humbasë. Atij i pëlqen të plakët por edhe të vdesë i ri. I pëlqen fillimi dhe fundi. Megjithatë, nuk duhet të jemi tepër skeptikë. “Fjalët nuk janë vetëm një erë që fryn”. Duhet të kujtojmë se fjalët “kanë diçka për të thënë”, dhe se gjuha është vetëm një depo kuptimesh dhe jo vetë kuptimi.

Ngjashëm, Zhuangzi argumenton se ne nuk mund ta mohojmë se jemi kafshë sociale. Disa detyra janë tipare të pashmangshme të roleve në të cilat gjendemi. Të jesh në këtë botë dhe jo jashtë saj, do të thotë ta pranojmë me qetësi atë që është përtej kontrollit tonë.

Skepticizmi terapatik dhe Ëndrra e Fluturës

Shembulli më i famshëm që jep Zhuangzi, ka të bëjë me një ëndërr: Njëherë e një kohë, unë ëndërroja sikur isha një flutur, duke fluturuar sa andej-këtej, nxitur nga të gjitha qëllimet dhe

dëshirat që ka një flutur. Isha i vetëdijshëm vetëm për lumturinë time si një flutur, pa e ditur se isha Zhuangzi.

Shumë shpejt u zgjova, dhe ja ku pashë që isha vërtet unë. Tani nuk e di nëse atëherë isha njëburrë që ëndërronte sikur ishte një flutur, apo nëse tani jam një flutur, që po ëndërroj sikur jam një burrë. Duke u argëtuar për një moment me idenë se të ëndërruarit sikur jemi një flutur që po ëndërron është njerëzore, ne përfshihemi tek vetë aktiviteti që na lejon të çlirohemi nga mënyra normale dhe njerëzore e të kuptuarit të botës.

Ky është një lloj skepticizmi terapatik. Përdorimi i kësaj perspektive më universale, e bën më të plotë dhe më emocionues të kuptuarit tonë. Me praktikën e duhur, jetët tona të zakonshme mund të mbushen me momente të frikës spontane. Ne mund të mësojmë të shohim transformimin e gjërave, se si çdo gjë bëhet në fund pjesë e diçkaje tjetër.


Duke e vënë në pikëpyetje botën përreth nesh, ne e kapërcejmë perspektivën tonë të kufizuar dhe nxitim një kuriozitet të pakufishëm për gjithçka në kozmos. Në shekullin XX-të, filozofiadhe romancierja Iris Murdoch e përshkroi si një

“shkëputje nga vetja” virtytin më të lartë të nevojshëm për të pasur një jetë të përmbushur.

“E mira është një realitet transcendent” – shkroi ajo, dhe mungesa e vetes, ose përfshirja në këtë akt terapatik të skepticizmit, na lejon të “çajmë shpojme velin e ndërgjegjes egoiste, dhe t'i bashkohemi botës ashtu siç është në të vërtetë”. Zhuangzi dhe Murdok mund të pajtohen se ajo që na bën njerëz, është pikërisht aftësia jonë për të kapërcyer perspektivën tonë njerëzore, dhe për ta parë botën si një flutur.

Ne mund ta gjejmë veten tonë thelbësore, vetëm kur jemi të hapur ndaj kapacitetit tonë të madh për imagjinatë dhe krijimtari. Ne mund të çlirohemi nga dallimet, idetë dhe traditat që burgosen tek fjalët që përdorim. Një mendim i fundit: Ndoshta është më mirë që Zhuangzi të lihet i pa interpretuar.

Po e mbyll me një cilat që mua të kujton Sokratin dhe dëshirën e tij për dije. Por se çfarë do të thotë kjo varet nga ju: “Të gjithë njerëzit kërkojnë të dinë atë që nuk e dinë ende; do të ishte më mirë që ata të kërkojnë të dinë atë që dinë tashmë.” / “Big Think” – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Të shtunën boksojnë dy shqiptarët Altin Zogaj dhe Festim Kryeziu



PRISHTINË, 2 SHKURT - Boksieri shqiptar Altin Zogaj të shtunën do të përballlet me një kundërshtar nga Armenia, Hovhannisyan, i cili jeton në Gjermani dhe është kampion momentalisht në Federatën Botërore WBA dhe mban brezin WBA Continental Champion, po ashtu është kampion në Federatën Botërore WBC dhe mban brezin WBC Asian Boxing Council Continental. Shqiptari Altin Zogaj duhet ta mposhtë këtë kundërshtar dhe do t'i lejohet të boksojë në qershor për titullin kampioni i Evropës. Duhet cekur se ishte titulli më i lartë të cilën arriti ta fitonte në boksion profesionist, Luan

Krasniqi. Por, sipas drenicasit Zogaj, është fokusi njëherë te sfida e së shtunës: Fillimisht do t'i kushtoj shumë vëmendje dhe do të koncentrohet në sfidën e së shtunës, ka thënë Zogaj, i cili në tre muajt e fundit ka stërvitur nga dy herë në ditë vetëm që të jetë në formën më të mirë për përballjen e radhës.

Lajm i mirë është që Zogaj i ka kaluar me sukses stërvitjet dhe pa asnjë lëndim.

Në të njëjtën mbrëmje do të ketë meçin kryesor bokseri Festim Kryeziu me nofkën "Timo Schwarzkopf" nga Mleqani. Kryeziu do të sfidohet me një meksikan i cili ka provojë dhe suksese të madh në karrierën e tij.

Disa nga sukseset e meksikanit janë kampione bote shtatë herë në karrierën e tij dhe ka boksuar kundër gigantit meksikan Canelo Alvarez në 10 raunde, ku është mposhtur me poenë. Synim i Kryeziut është ta mposhtë meksikanin dhe, po ashtu, në qershor të ketë të drejtë të boksojë në Federatën Botërore IBO për titullin e botës IBO World Champion. Zogaj si mbështetës dhe prezantues në të gjitha ndeshjet e tij me emblën e UÇK-së do ta ketë hyrjen në ring me këngën (Marshi i UÇK-së). Kryeziu do të hyjë me këngën e Ilir Shaqirit (Prite-prite). Këto dy meçe do të transmetohen në televizionin publik RTK1 në orën 22:40.

Më 16 shkurt luhen ndeshjet e Superkupës së Kosovës

ISTOG, 2 SHKURT - Superkupa e Kosovës "Pavarësia 2023" do të organizohet më 16 shkurt në Palestrën e Qytetit në Istog. Komisari i Garave, Isak Osmani, duke u mbështetur në planprogramin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe kalendarin e aktiviteteve për festën e Pavarësisë së Kosovës, ka vendosur që të organizojë këtë aktivitet. Po

ashtu, është vendosur që prej këtij viti ndeshjet për Superkupë të jenë pjesë e kalendarit të FHK-së. Në konkurrencën e hendbollistëve takohen Besa Famgas e Kastrioti. Besa ka fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës, ndërsa Kastrioti ishte në finale të Kupës. Kjo ndeshje luhet prej orës 15:30, ndërsa te hendbollistët prej orës 18:00



takohen Istogu e Ferizaj. Istogu ka fituar dy trofetë, kurse Ferizaj ishte në të dy finalët e edicionit të kaluar.

SHKURT

Visoka nuk është më trajner i Flamurtarit

Megzon Visoka ka dhënë dorëheqje nga detyra e trajnerit të Flamurtarit. Njoftimin e ka dhënë klubi kryeqytetas në faqen zyrtare në "Facebook". "KF Flamurtari njofton se kryetrajneri i deritanishëm Megzon Visoka ka dhënë dorëheqje nga posti i kryetrajnerit. Klubi e falënderon për punën e bërë deri më tani dhe njëkohësisht i uron shëndet e suksese në vazhdim. Pas kësaj, klubi do të bëjë vlerësimet e nevojshme dhe në ditët në vazhdim do të njoftoheni për zhvillimet në këtë drejtim", thuhet në njoftimin e klubit kuqezii.

Gjilani konfirmon largimin e katër futbollistëve

Skuadra e Gjilanit ka njoftuar për largimin e katër futbollistëve. Arion Ymeri, Fabjan Beqja, Besart Krivanjeva dhe Agustin Torassa nuk do t'i mbrojnë ngjyrat e klubit nga Anamorava. "Klubi falënderon publikisht gjithë futbollistët për angazhimin dhe kontributin e dhënë me fanellën 'kuqebardh', duke u dëshiruar njëherit fat dhe sukses në karrierën sportive", thuhet në njoftimin e klubit gjilanas. Sport Club Gjilani sezonin vjeshtor në Superligë e mbylli në pozitën e katërt me 27 pikë të grumbulluara.

Varane pensionohet nga kombëtarja

Mbrojtësi qendror Raphael Varane i ka dhënë fund aventurës së tij te Përfaqësuesja e Francës. 29-vjeçari i Manchester Unitedit e ka marrë këtë vendim i cili është bërë zyrtar edhe nga Federata e Futbollit e Francës. "Pas 10 vjetëve dhe 93 paraqitjeve me Francën, Raphael Varane ka vendosur të tërhiqet nga Kombëtarja. Faleminderit për gjithçka, Varane!", ka shkruar faqja zyrtare e Francës. Varane me Francën ka arritur ta fitojë Kupën e Botës në vitin 2018 dhe Ligën e Kombeve në vitin 2021.

Dukagjin i paraqet dy transferimet e reja

Dukagjini i Klinës ka zyrtarizuar dy transferimet e reja në afatin kalimtar dimëror, edhe pse ky është mbyllur më 31 janar. Fjala është për dyshen Gentrin Salihu e Faton Neziri. Salihu u bashkohet klinasve pas një periudhe në Portugali te grupmoshat e Portos. Emri tjetër që i është bashkuar skuadrës së udhëhequr nga Armend Dallku është Faton Neziri i ardhur nga Drenica. "Futbollisti i talentuar Salihu vjen nga grupmoshat e Portos U19, me të cilët është aktivizuar përgjatë një vit. Në Portugali ishte transferuar nga skuadra e Besës nga Peja, me të cilën është paraqitur në tridhjetë ndeshje në Superligën e Kosovës, si një 17-vjeçar. Gentrin luan në pozitën e mesfushorit qendror. Futbollisti 20-vjeçar Neziri vjen nga klubi i Drenicës, ku është paraqitur sezonin vjeshtor. Fatoni që me tipare është një mesfushor i krahut të majtë, në disa ndeshje të sezonit vjeshtor e ka mbuluar për mrekulli edhe pozitën e mbrojtësit të krahut të majtë. Neziri për një edicion ishte aktivizuar edhe te skuadra e Istogut në ligën e parë, ku tregoi paraqitje mjaft solide", thuhet në njoftimin e KF Dukagjini.

Chelsea rezikon të dënohet nga UEFA

LONDËR, 2 SHKURT - Skuadra e Chelsea shpenzoi për transferime në sezonin 2022/23 rreth 600 milionë. Blutë e Londrës janë duke u hetuar nga UEFA për shkeljen e "fair-play"-it financiar për

një periudhë prej tetë vjetësh. Sipas "The Times", kjo shkelje mund t'i kushtojë rëndë ekipit londinez nëse nuk kualifikohet në Ligën e Kampionëve. Chelsea për momentin mban vendin e 10

me një diferencë prej 10 pikësh nga ekipi i fundit që gjendet në zonën Ligës së Kampionëve. Për ta shmangur dënimin, alternativa është që ta fitojë Ligën e Kampionëve. Pasi

fituan grupin, blutë e Londrës në fazën e 1/8-ve do ta sfidojnë Borussia Dortmundin. Vitin e kaluar skuadra londineze u fal vetëm për shkak të krizës që ndodhi nga pandemia Covid-19.



Kosova U21 në grup me Gjermaninë, Tovërlani: Nuk frikësohemi nga askush



PRISHTINË, 2 SHKURT - Në selinë e UEFA-s në Nion të enjten është bërë tërheqja e shortit për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Sllovakia 2025" për grupmoshën deri 21 vjeç. Përfaqësuesja e Kosovës U21 është përfshirë në Grupin D, ku bëjnë pjesë edhe Gjermania, Polonia, Izraeli, Bullgaria dhe Estonia. Ky cikël kualifikues fillon në muajin mars, derisa përmbillet në muajin tetor të 2024-s. Ndeshjen e parë Dardanët U21 e luajnë kundër Estonisë më 20 qershor në shtëpi. Kjo është hera e dytë që Kosova U21 do të përballet me Gjermaninë dhe Izraelin, ngaqë

për herë të parë me këta dy kundërshtarë është ballafaquar edhe në ciklin kualifikues Euro 2019. "Larg asaj për të nënçmuar ndonjë ekip, por mendoj se jemi në situatë për t'u mos iu frikësuar asnjë kombëtareje. Ne do të bëjmë më të mirën. Shpresoj të mos kemi lëndime dhe ta kemi grupin e shëndoshë, duke insistuar të luftojmë për një pozitë sa më të mirë. Duhet ta dimë se kualifikimet e fundit na e kanë bërë punën më të vështirë sepse kemi rënë në vazon e pestë. Pra, theksoj edhe një herë as nuk e nënçmojmë askënd dhe as nuk i frikësohemi askujt. E kemi një

grup të mirë të futbollistëve. Shpresoj që ata të kenë minutazh më të madhe në klubet e tyre. Jam më se i bindur se do të kalojmë mirë në këtë grup", ka theksuar pas shortit përzgjedhësi i U21-shave, Afrim Tovërlani.

Shqipëria U21 në grup me Rumaninë, Zvicrën, Finlandën, Malin e Zi dhe Armeninë

Është hedhur sot shorti në selinë e UEFA-s në Nion të Zvicrës, ku janë përcaktuar 9 grupet përbërëse të kualifikueseve të Kampionatit Evropian 2025 për grupmoshat U-21. Shqipëria është pozicionuar në Grupin E dhe kundërshtarët do të jenë Rumania, Zvicra, Finlanda, Mali i Zi dhe Armenia. Sipas kalendarit të UEFA-s, ndeshjet e fazës kualifikuese të Evropianit U-21 do të nisnin më datë 20 mars 2023 dhe do të përfundojnë më 15 tetor 2024. Shqipëria U-21, e drejtuar nga trajneri Alban Bushi, do të synojë të kualifikohet për herë të parë në fazën finale të këtij turneu, që do të luhet në vitin 2025 në Sllovakia.

Golden State dorëzohet në shtesë, Bostoni u jep leksion rivalëve të Brooklynit

MINNESOTA, 2 SHKURT - Koha shtesë dënon skuadrën kampione të Golden States, që u mund me rezultat 119-114 nga Minnesota, në një ndeshje me shumë emocione dhe rivalitet. Stephen Curry realizoi 29 pikë e 10 rebounde, por që s'mjaftuan për të fituar, ndërsa për vendasit u dalluan Russell me 29 pikë e Edwardsi me 27. Fitore të thellë korri Bostoni, ekip që kryeson në Lindje. Celticsi fitoi me shifrat



139-96 ndaj Brooklynit, sfidë ku dallimin e bëri Jayson Tatum me 31 pikë. Zhgënjeu Memphisi, pasi u mund me rezultat 122-112 nga Portlandi, por qëndron i dyti në Perëndim. Për miqtë u dallua Damian Lillard me 42 pikë e 10 asistime. Utah Jazzi, falë 28 pikëve e 13 reboundeve të Markkanenit,

mundi me rezultat 131-128 Toronton (VanVleet një triple double, me 34 pikë, 12 rebounde, 10 asistime). Jashtë fushës fiton edhe Atlanta, që mundi me rezultat 132-100 Phoenixin (Murray 21 pikë), ndërsa Sacramento mposhti 119-109 San Antonion (Sabonis 34 pikë e 11 rebounde).

REZULTATET

Detroit - Washington	(e shtyrë)
Memphis - Portland	112-122
Philadelphia - Orlando	105-94
Boston - Brooklyn	139-96
Houston - Oklahoma	112-106
Minnesota - Golden State	119-114
San Antonio - Sacramento	109-119
Utah Jazz - Toronto	131-128
Phoenix - Atlanta	100-132

Garcia paralajmëron rikthimin e Ronaldos në Evropë

Cristiano Ronaldo mund të jetë lojtari më i pagur në botë, por në fushë ylli portugez po has në shumë vështirësi.

Përshtatja e tij me skuadrën e Al-Nassrit nuk po shkon sipas parashikimeve, nuk po arrin të lë gjurmë. Ky fakt nuk është

pritur mirë nga tifozët, por as nga shekët e klubit. As trajneri Rudi Garcia nuk ka përdorur lojërë fjalësh për ta justifikuar

portugezin, por ka vënë në pah mangësitë e tij. Ndër të tjera, trajneri Garcia shtoi se Ronaldo është një nga lojtarët

më të mirë në botë dhe se karriera e tij nuk do të mbyllet tek Al-Nassr, por do të rikthehet në Evropë.

SHKURT

Mbappe rezikon sfidën ndaj Bayernit

Kylian Mbappe luajti vetëm në njëzet minutat e pjesës së parë ndaj Montpellierit. Sulmuesi francez pësoi një lëndim dhe në Paris janë të shqetësuar, pasi më 14 shkurt do të luhet dueli i 1/8-së në Ligën e Kampionëve ndaj Bayern Munchenit. Pas një përplasjes me Leo Leroy, Mbappe preku disa herë anën e majtë të këmbës dhe pak më vonë kërkoi një zëvendësim. Gjendja e francezit pritet të vlerësohet.

Silva planifikon vazhdimin e kontratës me Chelsean

Thiago Silva vazhdon të jetë një nga lojtarët më të rëndësishëm të Chelsea-edhe pse në moshën 38-vjeçare. Duket se braziliani ka marrë një vendim në lidhje me të ardhmen e tij të "Blutë". Siç bëjnë me dije mediet angleze, ai është gati të rinovojë dhe për një vit tjetër me londinezët. Chelsea vazhdon ta dojë në skuadër brazilianin pasi 38-vjeçari vazhdon të shfaqë siguri në mbrojtje.

Shtatë yje të Realit mbeten pa kontratë, klubi nis fushatën e rinovimeve

Shtatë futbollistëve të Real Madridit u përfundon kontrata në fund të sezonit, por drejtuesit e klubit kanë filluar të punojnë për rinovimet. Luka Modriq, Karim Benzema, Nacho, Marco Asensio, Dani Ceballos, Mariano Diaz dhe Toni Kroos janë lojtarët që në fund të sezonit mund të mbeten të lirë. Reali ka planifikuar që Benzema dhe Modriqi të vendosin për fatin e tyre, kurse kontrata e Mariano Diaz pritet të rinovohet. Ndërsa për mesfushorin gjerman Toni Kroos ende nuk dihet se çfarë do të ndodhë, pasi ekziston mundësia që ai rinovon vetëm për një sezon pasi mund të pensionohet.

Mick Schumacher bëhet me dy skuadra, firmos edhe me McLaren

Pas Mercedesit është radha e McLarenit. Piloti i ri gjerman Mick Schumacher, që më herët këtë vit kishte firmosur si pilot rezerv i Mercedesit, sot do ta mbulojë edhe detyrën e pilotit rezervë të McLarenit. Lajmin e konfirmoi makina britanike përmes një postimi në rrjetet sociale. Mick do ta ndajë këtë detyrë mes dy skuadrave, duke qenë se McLarenin përdor motorin e Mercedesit, duke dhënë një ndihmë të madhe me informacione për të dyja këto makina. Pak ditë më parë Schumacheri ka provuar ulësen e makina Mercedes, duke ndjekur gjurmët e babait të tij. "Formula 1 është një sport mjaft magjeps dhe gjithnjë ka diçka të re për të mësuar. Mezi pres ta jap maksimumin tim për ta ndihmuar Mercedesin", ka thënë Mick Schumacheri, që e konsideron këtë si një vit tranzicioni. Ai synon të rikthehet vitin tjetër si pilot zyrtar pas dy sezoneve jo fort të mira me Haas.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
Obaveštajna Agencija Kosova
Kosovo Intelligence Agency



Bazuar në Ligjin nr.03/L-063, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), shpall:

KONKURS
Për punonjës/e të AKI

Numri i referencës: AKI 1/2023
Nivelet e pagave: Të klasifikuara
Orari i punës: I plotë
Kohëzgjatja e kontratës: E pacaktuar
Vendet e punës: AKI

Konkursi shpallet në fushat:

1. Inteligjencë;
2. IT, Programim;
3. Kibernetikë;
4. Siguri fizike;
5. Shërbime mbështetëse administrative;

Kualifikimet dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit:

- Kandidatët për fushën 1 duhet të kenë përgatitje universitare;
- Kandidatët për fushën 2 duhet të kenë përgatitje universitare dhe kualifikime nga fusha e teknologjisë informativë;
- Kandidatët për fushën 3 duhet të kenë përgatitje universitare apo arsimim të mesëm, si dhe njohuri të thelluara në fushën kibernetike të dëshmuara me certifikata përkatëse;
- Kandidatët për fushat 4 dhe 5 duhet të kenë kualifikim të mesëm;
- Për fushat 1,2,3 është obligative njohja e gjuhëve të huaja. Përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri në gjuhën angleze dhe serbe. Kandidatët do të nënshtrohen testimit të njohurive në gjuhët e huaja.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për punësim në AKI si më poshtë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë mbi moshën 18 vjeçare;
- Të kenë kualifikimet e duhura arsimore dhe profesionale;
- Ndaj tyre të mos jetë marrë masa e përjashtimit ose e largimit nga puna në AKI apo institucionet e tjera me natyrë të ngjashme;
- Kalimi me sukses i procedurave të rekrutimit.

Kandidatët për punësim në AKI do t'i nënshtrohen ekzaminimit mjekësor, verifikimit të sigurisë si dhe mund t'u nënshtrohen edhe kushteve tjera specifike.

Të gjithë kandidatët të cilët deklarojnë të dhëna të pa sakta do të diskualifikohen gjatë procesit të verifikimit të sigurisë.

Përveç kushteve të mësipërme kandidatët duhet të plotësojnë edhe standardet strikte të sigurisë të parapara në nenin 14 i ligjit nr.03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Procedura e përzgjedhjes:

Procesi i brendshëm i përzgjedhjes është i klasifikuar dhe përbëhet nga disa faza të selektimit dhe testimit. Përzgjedhja e kandidatëve për pozitë përkatëse do të bëhet varësisht prej kualifikimeve, bazuar në kriteret dhe kushtet e përgjithshme të përshkruara në konkurs si dhe kriteret dhe kualifikimet tjera specifike të brendshme.

Kandidatët mund të aplikojnë në më së shumti dy fusha, kurse AKI do të bëjë selektimin për vazhdim të procedurave konkurruese në njërin fushë/pozitë, në bazë të vlerësimit të profilit dhe përshtatshmërisë së kandidatit me kërkesat për pozitën përkatëse.

Kohëzgjatja e punësimit:

Punësimi në AKI është me afat të pacaktuar, pas përfundimit me sukses të periudhës provuese, bazuar në Ligjin për AKI, rregullat dhe procedurat e brendshme.

Procedura e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin për punësim dhe të bashkëngjitin dokumentet apo dëshmitë si në vijim:

- Cv dhe letër motivimi;
- kopjet e dëshmimeve për përfundim të studimeve të lëshuara nga institucionet arsimore (për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit diploma duhet të jetë e nostrifikuar) si dhe kualifikime të tjera, certifikatat e trajnimeve apo formave tjera të aftësisht profesional (nëse kanë);
- certifikata e lindjes/ekstrakti i lindjes apo kopja e letërnjoftimit/pasaportës (të jenë valide);
- një fotografi të formatit 5x5 (jo më e vjetër se një muaj);
- certifikata nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar (e lëshuar nga Gjykata, jo më e vjetër se tre muaj).

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në web faqen zyrtare të AKI www.aki-rks.org duke plotësuar aplikacionin dhe bashkëngjitur dokumentet e kërkuara për punësim.

Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit në mjete të informimit, përkatësisht nga data 03.02.2023 deri me datën 17.02.2023.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar më lartë nuk pranohen, kurse aplikacionet e mangëta/të pa kompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazat e mëtejme do të kontaktohen. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë ofron mundësi të barabarta për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e interesuar. Aplikimi nga ana juaj të jetë diskret.

Për çdo paqartësi mund të na kontaktoni në numrin e telefonit : 045 202 213.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
Obaveštajna Agencija Kosova
Kosovo Intelligence Agency



Na osnovu Zakona br.03/L-063, Obaveštajna Agencija Kosova (OAK), objavljuje:

KONKURS
Za radnika/radnicu OAK

Broj reference: AKI 1/2023
Nivo plate: Klasifikovano
Radno vreme: Puno
Trajanje ugovora: Neodređeno
Radna mesta: OAK

Konkurs se objavljuje u oblastima:

1. Obaveštajne delatnosti;
2. IT, Programiranje;
3. Kibernetika;
4. Fizička sigurnost;
5. Usluge administrativne podrške.

Opšti kriterijumi i uslovi za učešće u procesu regrutovanja:

- Kandidati za 1. oblast moraju imati visoku stručnu spremu;
- Kandidati za 2. oblast moraju imati visoku stručnu spremu i kvalifikacije iz oblasti informacione tehnologije;
- Kandidati za 3. oblast moraju imati visoku stručnu spremu ili srednje obrazovanje, kao i dobro poznavanje oblasti kibernetike, dokazano relevantnim certifikatima;
- Kandidati za 4. i 5. oblast moraju imati srednju kvalifikaciju;
- Za 1,2,3 oblast obavezno je znanje stranih jezika, imaće prednost kandidati sa poznavanjem engleskog i srpskog. Kandidati će biti testirani u oblasti poznavanja stranih jezika.

Kandidati moraju ispuniti opšte uslove za zapošljavanje u OAK, a to su:

- Da su državljanin Republike Kosova;
- Da su stariji od 18 godina;
- Da imaju odgovarajuće obrazovne i stručne kvalifikacije;
- Da se nad njima nisu preduzele mere otpuštanja ili izuzeća sa posla u OAK ili u drugim institucijama slične prirode;
- Uspešan prolazak procedura rekrutacije.

Kandidati za zapošljavanje u OAK će biti podvrgnuti lekarskom pregledu, verifikaciji bezbednosti i mogu biti podložni drugim posebnim uslovima.

Svi kandidati koji navedu netačne podatke će biti diskvalifikovani za vreme procesa verifikacije bezbednosti.

Pored gore navedenih uslova, kandidati moraju da ispune stroge bezbednosne standarde navedene u članu 14 Zakona br. 03 / L-063 o Obaveštajnoj Agenciji Kosova.

Postupak selekcije:

Unutrašnji proces selekcije je klasifikovan i sastoji se od nekoliko faza selekcije i testiranja. Izbor kandidata za odgovarajuće pozicije vršiće se u zavisnosti od kvalifikacija, na osnovu kriterijuma i opštih uslova opisanih u konkursu, kao i drugih specifičnih internih kriterijuma i kvalifikacija.

Kandidati mogu aplicirati u najviše dve oblasti, dok će OAK odabrati nastavak procedura konkurisanja u jednoj oblasti / poziciji, na osnovu procene profila i podobnosti kandidata sa zahtevima za odgovarajuću poziciju.

Trajanje zaposlenja:

Zaposlenost u OAK-u je na neodređeni rok, nakon uspešnog završetka probnog perioda, na osnovu Zakona o OAK, internih pravila i procedura.

Proces apliciranja:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti zahtev za zaposlenje i priložiti sledeća dokumenta ili dokaze:

- CV i motivaciono pismo;
- kopije dokaza za završetak studija koje izdaju obrazovne ustanove (za kandidate koji su završili obrazovanje u inostranstvu diplome moraju biti nostrifikovani), kao i ostale kvalifikacije, potvrde o obuci ili drugim oblicima stručnog osposobljavanja (ako ih ima);
- izvod iz matične knjige rođenih/rodni list ili kopiju lične karte/pasoša (važec);
- fotografiju formata 5x5 (ne stariju od jednog meseca);
- potvrdu iz evidencije osoba protiv kojih se vodi krivični postupak i osuđenih lica (izdata od Suda, ne starija od tri meseca).

Aplikacija se vrši samo elektronskim putem na zvaničnoj web stranici OAK www.aki-rks.org, popunjavanjem aplikacije i prilaganjem tražene dokumentacije.

Datum zatvaranja konkursa:

Konkurs će biti otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja, odnosno od datuma 03.02.2023 do datuma 17.02.2023.

Aplikacije podnesene nakon navedenog roka se ne prihvaćaju, dok nepotpune / nekompletirane aplikacije se odbijaju.

Samo odabrani kandidati za sledeću fazu će biti kontaktirani.

Kosovska Obaveštajna Agencija pruža jednake mogućnosti svim državljanima Republike Kosova i pozdravlja prijave svih zainteresovanih osoba. Apliciranje mora biti diskretno.

Za sve nejasnoće kontaktirajte nas na broj telefona: 045 202 213.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 02.02.2023 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-23-04

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e një pjese të ishe zjarrfikësve dhe Parcelave në njësisë biznesore Industria Kimike.
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes:	02.02.2023
Sqarimi:	deri me 16.02.2023
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 16.02.2023 Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	20.02.2023 në 11:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: hajdini_b@hotmail.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepccorporation.com		

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitore Zabërgja shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Zain Skenderi shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Arlind Gashi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren .

- Isuf Avdyli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curri " Krushe e Madhe.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues